



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
Nr. 01-060/126614
Më: 18 shtator 2024
P r i z r e n

Në bazë të nenit 8 pika 1, neni 9 pika 1.4 dhe pika 1.5, të Udhëzimit Administrativ, nr. 27/2012 MPB si dhe 03/2012 të MAPL, thërres mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, e cila do të mbahet me **25.09. 2024** në sallën e mbledhjeve të Asamblesë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës (**Shtëpia e Bardhë**), me fillim nga ora 10:00.

Për këtë mbledhjeje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Planet operative të ndërmarra nga Policia e Kosovës për ushtrimin e kontrollit në trafikun rrugor, për të zvogëluar aksidentet me fatalitet dhe vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Prizrenit, gjatë sezonit korrik –gusht;
3. Raporti nga Drejtoria e Arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2023-2024 dhe informatë për fillimin e vitit shkollor 2024-2025, masat preventive për sigurinë në shkolla, rekomandime dhe konkluzione nga takimet e organizuara nga DKA, nga arteret për sigurinë e arsimit, në Komunën e Prizrenit;
4. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike lidhur me mungesën e shenjave sinjalizuese në rrugën “Tirana”, dhe në të gjitha rrugët e Prizrenit, si dhe ndriçimi Publik;
5. Rekomandime dhe sugjerime nga ana e anëtarëve të KKSBS-së për organet gjegjëse, për vitin 2024;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i KKSBS-së
Shaqir Totaj

